

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-062/13**

**Prishtinë,  
12 shkurt 2014**

Në çështjen juridike të:

**N. M.S.**  
Sërbi

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

kundër

**H. L.**  
Podujevë

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Ermenkova-Filcheva, Kryetare e kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, Anëtar të kolegjit, duke vendosur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/135/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA36714), i datës 07 dhjetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 12 shkurt 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/135/2001, i datës 7 dhjetor 2011, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA36714.
2. Hedhet poshtë si e palejueshme kërkesa për pronën private e N. S.për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA36714.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 26 qershor 2007, N. S. në cilësinë e anëtarit të ngushtë të familjes ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte që babai i tij M. S. të njihej si pronar i ngastrës kadastrale Nr. 439 , në vendin e quajtur “Kodra e Merqezit”, në sipërfaqe prej 0.50.52 ha, arë, Zona Cadastrale Shtedim, e regjistruar në fletën poseduese Nr. 7, Komuna e Podujevës. Posedimi për këtë paluajshmëri është humbur me dt. 15 qershor 1999, si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999. Ai kërkon konfirmimin e të drejtës së pronësisë dhe ri posedimin
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP këto prova shkresore edhe atë:
  - (a) Fletën poseduese nr. 7, lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi i të Komunës së Podujevës, i dt. 28.dhjetor 2007 (UNMIK). Me këtë fletë poseduese konstatohet se titullar i së drejtës së pronësisë të ngastrës kadastrale që është objekt i kërkesës është S. N.;
  - (b) Çertifikatën e vdekjes për N. S., e dt.06.maj.1989, elëshuar nga Komuna e Podujevës, me të cilën konstatohet se ai ka vdekur me 02 qershor 1989 në Shtedim, Komuna e Podujevës. Këto prova janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i Sekretarisë Ekzekutive i AKP-ës.
3. Me 10 nëntor 2007, AKP-ja ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra. Në vitin 2010 AKP përsëri ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën, këtë herë duke e shpallur kërkesën në Gazetën Njoftuese Nr. 10, dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i ishin lënë kryesuesit të fshatit, i cili

kishte pranuar t'i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta gjithashtu ishin lënë në hyrje dhe dalje të fshatit Shtedim si dhe në disa zyra publike në Podujevë.

4. H.L. në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë pohon se babai i tij kishte këmbyer ngastrën e kërkuar me ngastrën tjetër në vitin 1974 me gjyshin e paraqitësit të kërkesës, N. R. S..

5. Me vendimin KPCC/D/A/135/2011 të datës 07 dhjetor 2011 ishte refuzuar kërkesa me arsyetim se paraqitësi i kërkesës ka pohuar deklaratën e palës përgjegjëse se babai i tije e kishte këmbyer pronën e kërkuar me një pronë tjetër me gjyshin e paraqitësit të kërkesës në vitin 1974. Ndonëse, janë akceptuar nga paraqitësi i kërkesës transaksionet e theksuara, ai nuk ka tërhequr kërkesën.

6. Me datën 27 dhjetor 2012, vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës (tani e tutje: pala ankuese). Ndërkaq, palës përgjegjëse vendimi i është dorëzuar me 02 maj 2012.

7. Me datën 24 janar 2013, ankuesi ka paraqitur një ankesë në AKP, ku pohonte se trashëgimtarët e të ndjerit S. R. N., në mes të viteve nëntëdhjeta me B.L. vëllaun e H. L. e kanë këmbyer ngastrën 439, arë, në sipërfaqe prej 0.50.00 ha, Zona Kadastrale Shtedim, me një arë tjetër në vendin e quajtur "ara e fatit", në sipërfaqe prej 20 ari. Ai po ashtu në ankesë deklaroi se nëse pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë është e gatshme, atëherë ky këmbim i ndërsjellë i këtyre pronave të paluajtshme mundet edhe të legalizohet. Më tutje ai deklaroi se nuk ka arsye që të ketë përfundime negative në lidhje me kërkesën KPA36714.

### **Arsyetimi ligjor:**

8. Ankesa është e pranueshme

9. Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave të cilat lidhen me Pronën e Paluajtshme, duke përfshirë këtu Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimin.

10. Gjykata Supreme konkludon se vendimi ankimor i KKPK-ës është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 par 2 nëpar. b të LPK-ës dhe nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, të cilat shkelje janë të natyrës absolute e për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Prandaj, mbi këtë bazë juridike vendimi ankimor anulohet duke hedhur kërkesën e paraqitësit të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate, dhe rrjedhimisht të KKPK-ës, sipas dispozitës së nenit 198 paragrafi 1 i LPK-ës.

11. Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtrij të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

12. Ankuesi/paraqitësi i kërkesës nuk e konteston faktin që gjyshi i tij i ndjerë S. R.N., në vitin 1974 me palën përgjegjëse në kërkesë/ankesë, pra me B. L. vëllain e H. L., e kanë këmbyer ngastrën 439, me kulturë arë e klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 0.50.52 ha, Zona Kadastrale Shtedim, e regjistruar sipas fletës poseduese nr. 7, Komuna e Podujevës, me një arë tjetër në vendin e quajtur “ara e fatit”, në sipërfaqe prej 20 ari. Po ashtu pala ankuese në ankesë pohon se është i gatshëm që të realizohet legalizimi i këmbimit të ndërsjellë i këtyre pronave të paluajtshme, nëse pala përgjegjëse është i gatshëm.

13. Pra, nga një gjendje e tillë e çështje, qartazi dhe me pa mëdyshje rezulton se ,nuk është kontestuese që pretendimet e paraqitësit të kërkesës- ankesës për humbjen e posedimit nuk ndërlidhen e as që janë pasojë e konfliktit të armatosur në vitin 1998/99.

14. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen është dashur të anulohet vendimi i KKKPK-së në lidhje me kërkesën në fjalë dhe kjo kërkesë të hidhet poshtë pasi që është jashtë kompetencave të KKKPK-së dhe gjykatës sipas dispozitës së nenit 198 par 1 të LPK-ës.

### **Udhëzim juridik:**

15. Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

***Elka Ermenkova-Filcheva, Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Esma Ertezi, Gjyqtare e EULEX-it***

***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

***Urs Nufër, Referent i EULEX-it***